

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me sekretaren juridike Nushe Kadrija, në lëndën penale kundër të pandehurit N. S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr. 507/2015 të datës 03.12.2015, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 24.04.2017 merr këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri:

**N. S.**, nga i ati S., e ëma Z., e gjinisë Ll., i lindur me... në fshatin M., Komuna e Gjakovës, me profesion punëtor krahu, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar- shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal....

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 05.04.2015, në shtëpinë e prindërve të tij, e cila gjendet në Gjakovë në rrugën “Gj. N. K.” seriozisht e kanos me qëllim frikësimi të dëmtuarin babait të tij S., në atë mënyrë që derisa ishte në shtëpi, i pandehuri kapë për krahu e dërgon në podrum të shtëpisë dhe e kanos me fjalët “ do të vras”, me ç ’rast të dëmtuarit i shkakton frikë dhe ankth.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

### U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

**Pranohet** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP. nr. 507/2015 të datës 03.12.2015.

Andaj, gjykata ne kuptim të nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, 46, 73 të KPRK-së dhe nenit 185 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

### D Ë N I M I N M E G J O B Ë

Në lartësinë prej 200 (dyqind ) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ta paguaj gjobën apo nuk mund ta paguaj shumën e mbetur të dënimit me gjobë, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga 20 (njëzet) Euro.

I dëmtuari S. S. nga fshati M., Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

I pandehuri obligohet që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 20 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me numër PP. nr. 507/2015 të datës 03.12.2015, kundër të pandehurit N. S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.1 të KPRK-së, të cilës ia ka bashkangjitur edhe kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së, dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: nga deklarata e të dëmtuarit S. S. dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë, me datën 19.01.2015, deklarata e të dëshmitares Z. S. dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë, me datën 19.01.2015, raporti i oficerit policor A. Sh. PK #88658 i datës 08.04.2015, dëftesa mbi konfiskimin e pronës, deklarata e të pandehurit N. S. e dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë, me datën 08.04.2015, si dhe shkresat tjera të bashkangjitura në lëndë, është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë veprë penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallin gjyqësor u mur në kuptim të nenit 450 par. 2 nënpar 2.6 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha me lartë, në kuptim të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**

**- Departamenti i përgjithshëm -**

**P.nr.747/15 të datës 24.04.2017**

**Procesmbajtësja,  
Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjyqës,  
Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Nëse i akuzuari nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.